



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.508/2025

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli, Kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK NISMA Socialdemokrate, Konservatorët dhe Intelktualet, me seli në Prishtinë, dhe Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.02.2025, merr këtë,

#### V E N D I M

REFUZOHEN te pabazuara ankesat Anr.508/2025 dhe Anr.510/2025 të datës;10.02.2025, të parashtruara nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN me seli në Prishtinë, kundër Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK NISMA Socialdemokrate, Konservatorët dhe Intelktualet, me seli në Prishtinë, dhe Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për ditën e votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

#### A r s y e t i m

Me datën 10.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat Anr.508/2025 dhe Anr.510/2025, nga e Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN me seli në Prishtinë me të cilën pretendon se në Qytetin e Deçanit brenda qendrës së votimit 0101, në të cilën shihet qartë vizitë karta e Arton Demhasaj me nr. Rendor 35, nga radhët e subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Po ashtu me datën 09.02.2025 në shkollën “ Abdyl Frasheri” në qendrën e votimit 2002 në Prizren, është vërejtur material zgjedhor-vizitë karte në veturë, të kandidatës për deputete nga Subjekti Politik LDK.

Si provë në ankesa janë bashkangjitur foto.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur më datën 10.02.2025, Koalicionit AAK-NISMA Konservatoret dhe Intelektualet, pretendon se kandidati për deputet z. Arton Demhasaj nuk ka thyer heshtjen zgjedhore në ditën e votimit duke hedhur kartë vizitë e tij brenda objektit të një shkolle, sepse në asnjë moment prej fotos së dërguar nuk vërtetohet se kartë-vizita si e tillë është gjetur brenda objektit të ndonjë shkolle, nuk vërtetohet në asnjë mënyrë data e "shkeljes" pasi që mundësit janë reale të ketë ndodhu më herët dhe për fund çdo person mund ta bënte pa dashje një gjë të tillë duke e hedhur pa qëllim kartë-vizitë në tokë.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur më datën 10.02.2025, nga Subjekti Politik LDK pretendohet se kandidatja e LDK, znj. Ajlin Shishko me rastin e shpërndarjes së vizitkartave me foton e saj në veturë nuk përben asnjë shkelje të nenit 37 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 1 dhe 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.508/2025 dhe Anr.510/2025, të datës 10.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët Anr.508/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN, kundër dy subjekteve të ndryshme politike për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

#### **Ankesat janë të pabazuara.**

Pretendimet ankimore të parashtruesve të ankesave se kandidati nga Koalicioni AAK-NISMA dhe Kandidati nga Subjekti Politik LDK, kanë shpërndarë material zgjedhor/vizitë karta brenda qendrës së votimit 0101 në Deçan si dhe në shkollën "Abdyl Frashëri" në qendrën e votimit 2002 në Prizren, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.08/L-228 i cili përcakton "1. Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi të votuesit; bërja e fushatës në çfarëdo mënyrë." pasi që në fotografrit e bashkangjitura në ankesa shihen vetëm disa vizitë karta të shpërndara në një hapësirë e cila nuk mund të identifikohet se e njëjta është qendër e votimit si dhe vizitë karta e shpërndarë në veturën e kandidatës nga LDK, nuk ka të bëjë me shkeljet e pretenduara.


Në bazë të provave të bashkangjitura shkresave të lëndës dhe pretendimet e palës ankuese paneli vlerësoi se pretendimi ankimor për shpërndarjen e materialit zgjedhor/vizitë karta

brenda qendrës së votimit 0101 në Deçan përkatësisht në shkollën “ Abdyl Frashëri” në qendrën e votimit 2002 në Prizren, janë të paqëndrueshme dhe si të tilla Paneli i refuzoi për faktin se Koalicioni AAK NISMA si dhe subjekti politik LDK, me veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi, nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime janë ndërmarr nga subjektet në fjalë, kundër të cilëve janë paraqitur ankesa, për të ardhur në përfundim se janë bërë shkelje të dispozitave të lartcekura të Nenit 37 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe sipas Rregullës NR.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, neni 5, paragrafi 1. nën paragrafi 1.3 ankesat që dorëzohen në PZAP për shqyrtim duhet të përmbajnë këto të dhëna: 1.3. kohën, datën dhe orën kur ka ndodhur shkelja, ku në rastin konkret parashtruesi i ankesës nuk ka dhënë hollësi që të dihet se ku janë shpërndarë këto njoftime, në cilën datë ka ndodhur shkelja e pretenduar dhe nga provat e ofruara nuk mund të identifikohet objekti se ka ndodhur shpërndarja e materialeve zgjedhore, andaj ne prani të këtyre rrethanave ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Kështu që paneli vlerësoi se parashtruesit e ankesave në mbështetje të pretendimeve, nuk kanë ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar kanë shpërndarë material zgjedhor në hapësira të palejuara konkretisht në ndërtesa dhe automjete, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës  
Anr.508/2025, datë: 12.02.2025



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.